



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 211/3 prot.

Gramsh, më 27.02/2022

VENDIM

Nr. 5 datë 28.01.2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.132, DATË 29.12.2021 PËR “MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR QË STUDIOJNË NË SHKOLLËN E MESME PUBLIKE “SHEFQET GUZI” GRAMSH TË AKOMODUAR NË KONVIKTIN E KËSAJ SHKOLLE, TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSËS PËR VITIN MËSIMOR 2021-2022”.

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 28/01/2022 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe VKM. nr.666 datë 10.10.2019 për “Kuotat finaciare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik , për vitin shkollor 2020-2021, pika 2.4 /b (jashtë kriterit ekonomik) për nxënësit me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit ku përfshihet Bashkia Gramsh, si dhe shkresës nr.7334 prot, datë 30.12.2021 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit para-universitar për vitin akademik 2021-2022, me banim në juridiksonin e Bashkisë Gramsh, ku numri i bursave të miratuara është 42 (dyzet e dy), si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga zv/Kryetari i Bashkisë.

VENDOSI

1. Të ndryshojë pikën 1 të listës emërore me **42 (dyzet e dy) nxënës** me 100 % B (Bursë të plotë) që ndjekin studimet para-universitare dhe që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2021-2022, duke shtuar edhe tri nxënës të tjerë dhe duke e çuar listën emërore me **45 (dyzet e pesë) nxënës** nga të cilët 43 (dyzet e tre) nxënës me 100% B (Bursë të plotë) dhe 2 (dy) nxënës me 50% B (Gjysëm burse).
(Lista emerore me të dhënat përkatëse, bashkëngjitur këtij projekt-vendimi si pjesë përbërse e tij).
2. Pikat e tjera mbeten të pandryshuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSH. BASHKIAK
XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr:
Afati i ruajtjes: RHR

